



Kingdom of the Netherlands

ALTIN GJETA

**NDIKIMI I METODOLOGJISË SË RE TË ZGJERIMIT
NË NEGOCIATAT E GRUPIT TË PARË TË KAPITUJVE
TË SHQIPËRISË ME BE-NË**

Dokument Politikash



GJETJET KRYESORE

Rruga e integritit europian të Shqipërisë tashmë është e lidhur ngushtë me Metodologjinë e Re të Zgjerimit të miratuar unanimisht nga Këshilli i Bashkimit Europian (Këshilli) në mars 2020. Ndryshimet që Metodologjia e Re sjell në politikën e zgjerimit të BE-së janë gjithëpërfshirëse dhe të thella. Mekanizmat e rinj parashikojnë rritjen e besueshmërisë tek procesi nëpërmjet forcimit të koordinimit politik ndërmjet BE-së dhe vendeve negociuese; grupimin e kapitujve në gjashtë blloqe për të injektuar dinamizëm të ri në procesin e zgjerimit; dhe së fundi bërjen e procesit më të parashikueshëm. Për herë të parë, Metodologjia e Re e zgjerimit parashikon sanksione ndaj vendeve negociatore, nëse ka ngecje ose regres në zbatimin e reformave, ndërkohë vendet negociuese do të afrohen më shumë me BE-në në rast se arrihet përparim i prekshëm në procesin e integritit. Në këtë kontekst, Metodologjia e Re duket si një thikë me dy presa përkundrejt anëtarësimit të Shqipërisë në BE; mund ta presë nyjën Gordiane të integritit europian të Shqipërisë, por nga ana tjetër mund ta shtrëngojë nyjën edhe më shumë.

Forcimi i koordinimit politik midis BE-së dhe Shqipërisë pritet të ndikojë pozitivisht në përpjekjet e kësaj të fundit për anëtarësim në BE. Institucionet e BE-së dhe shtetet anëtare do të monitorojnë më nga afër reformat themelore të Shqipërisë, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit dhe funksionimit të institucioneve demokratike. Dialogu i lartë dhe i rregullt politik ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë do të rrisë trysninë mbi të dyja palët për të përmbushur angazhimet e tyre përkatëse; Shqipëria në zbatimin e reformave themelore, ndërsa BE në mbajtjen e premtimit dhe shpërblimin e arritjeve të Shqipërisë në rrugën drejt BE-së. Nga ana tjetër, negociimi në blloqe i kapitujve do ta bëjë procesin teknikisht dhe politikisht më kërkuese për Shqipërinë. Stabiliteti i brishtë politik,

koordinimi i dobët mes agjencive shtetërore, si dhe mungesa e burimeve dhe kapaciteteve institucionale, me shumë gjasa do të ndikojnë negativisht në procesin e integritit European. Megjithatë, vendosja e një theksi më të madh mbi reformat themelore mund të adresojë të metat e Shqipërisë në fushën e sundimit të ligjit dhe funksionimit të institucioneve demokratike. Vendi tashmë ka bërë progres të mirë në reformën në drejtësi, duke hedhur kështu themele të qëndrueshme për reformat e tjera integruese. Kjo mund të përshpejtojë rrugën e integritit european të Shqipërisë.

Për sa i përket funksionimit të institucioneve demokratike, Metodologjia e Re nuk ofron mekanizma të rinj domethënës për të frenuar predispozicionin e Shqipërisë ndaj krizave politike artificiale dhe koordinimit të dobët ndër-institucional. Shpesh, integrimi european në Shqipëri është sakrifikuar për përfitime politike afatshkurtra. Kjo mund të dëmtojë funksionimin e institucioneve demokratike dhe në këtë mënyrë të zgjasë procesin e anëtarësimit të vendit në BE. Megjithatë, masat korigjuese mund të prishin status quo-në dhe të rivitalizojnë integrimin European të Shqipërisë duke injektuar reformat e nevojshme në funksionimin e institucioneve demokratike. Por ndryshimet në procesin e vendimmarrjes në politikën e zgjerimit të BE-së mund të nxjerrin në sipërfaqe interesa gjeopolitike në rajon ose mosmarrëveshje dypalëshe midis vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve negociuese. Shqipëria nuk ka çështje serioze të hapura me fqinjët apo me ndonjë shtet anëtar të BE-së, përveç mosmarrëveshjes për kufirin detar në detin Jon me Greqinë. Me rritjen e fuqisë së vetos së shteteve anëtare gjatë gjithë procesit negociues, dikush në Union gjithmonë mund t'i thotë jo një vendi negociues. Shqipëria nuk është immune ndaj këtij rreziku potencial.

HYRJE

Shqipëria ka firmosur Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit në vitin 2006 dhe zyrtarisht paraqiti kërkesën e saj për anëtarësim në BE në 2009-ën.¹ Ndryshe nga sa pritej, gjatë dekadës së fundit Shqipëria bëri pak përparim në rrugën e integritit në BE. Kjo ngecje mund t'i atribuohet kryesisht krizave të brendshme politike midis qeverisë dhe opozitës, progresit të pamjaftueshëm në reformën në drejtësi, rezultateve të dobëta të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe regresit të vazhdueshëm demokratik.² Ndërkohë, kriza financiare e 2008 dhe e refugjatëve në 2015, krijuan terren të përshtatshëm për fuqizimin e lëvizjeve populiste dhe euroskeptike. Brexit dhe mosmarrëveshjet e tjera të brendshme ulën oreksin e BE-së për të pranuar anëtarë të rinj në një shkallë të tillë, sa presidenti i Komisionit të BE-së Juncker bllokoi zgjerimit e Unionit për 5 vite, dhe i dha përparësi thellimit të integritit të brendshëm dhe reformave strukturore në qeverisjen së BE-së.

Në vitin 2014, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidatit për në BE, por për katër vite radhazi nuk ajo arriti të merrte dritën jeshile nga Komisioni për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Vetëm në prill 2018, Komisioni lëshoi një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me BE-në. Megjithatë, ndryshe nga Maqedonia e Veriut, Këshilli European kushtëzoi hapjen e negociatave me kusht që Shqipëria të bënte përparim të prekshëm në avancimin e mëtejshëm të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve; finalizimin dhe ngritjen e strukturave të pavarura gjyqësore të parashikuara nga reforma kushtetuese, përkatësisht Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) dhe Gjykatës

¹ European Commission, “European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations, Albania”, last modified 2021, Brussels.

² European Commission, “Albania Report”, 2015; 2016; 2017; 2018, Final report, Brussels.

Kushtetuese; hetime proaktive, ndjekje penale dhe rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë atë në nivele të larta.³

Sipas raportit vjetor të Komisionit të vitit 2019, Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në përmbushjen e këtyre kushteve, por Këshilli European e shtyu vendimin për hapjen e bisedimeve dy herë, në qershor dhe tetor 2019. Më në fund, në mars 2020, të gjithë anëtarët e Këshillit European miratuan hapjen e negociatave me Shqipërinë.⁴ Megjithatë, vendimi pozitiv i Këshillit European shoqërohej me një listë kushtesh prej 15 prioritetesh të ndara përafërsisht në dy grupe: 6 kërkesa për t'u adresuar përpara konferencës së parë ndërqeveritare (KPNQ) dhe pjesa tjetër për t'u përmbushur përpara konferencës së dytë ndërqeveritare.⁵

Këshilli Evropian arriti në përfundimin se përpara KPNQ, Shqipëria duhet të:

- Miratojë reformën zgjedhore;
- Zbatojë reformën zgjedhore dhe garantojë funksionimin e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese;
- Krijojë dhe vendosë në funksion të plotë Njësinë e Prokurorisë së Posaçme për Luftën kundër Korrupsionit (SPAK) dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH) ;
- Për sa i përket luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar duhet të zbatohen rekomandimet e përcaktuara në planin e veprimit të Task Forcës;
- Marrë masa për të luftuar fenomenin e azilkërkimit dhe garantimin e riatdhesimit të azilkërkuesve, aplikimet e të cilëve refuzohen;
- Rishikojë ligjin e ri për median në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.⁶

Për më tepër, konkluzionet e Këshillit European theksonin se kuadri i negociatave do të miratohet me kusht që Shqipëria të adresojë me sukses prioritetet kryesore si:

- Procedim penal ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të vetingut dhe të akuzuarve për blerje votash;

³ General Affairs Council, "Council conclusions on enlargement and stabilisation and association process", 26 June 2018.

⁴ European Commission, "Albania Report", 2020, Final report, Brussels

⁵ Tobias Rutterhoff, "The Opening of Accession Negotiations: A New Hope for Albania". Tirana Observatory, May 8, 2020.

⁶ European Council's conclusions on enlargement and stabilisation and association process - Albania and the Republic of North Macedonia, Press release, March 25, 2020, Brussels.

- Të bëjë progres të prekshëm në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet, duke përfshirë fillimin e procedurave dhe përfundimin e procedurave të para kundër zyrtarëve të lartë publikë dhe politikanëve;
- Të bëjë progres të prekshëm në reformën e administratën publike, zbatimin e reformës së ligjit zgjedhor si dhe të dalë me një vendim përfundimtar për ligjshmërinë e zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019;
- Progres të mëtjshëm në miratimin e legjislacionit zbatues të mbetur në lidhje me ligjin kuadër të vitit 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare;
- Avancojë në procesin e regjistrimit të pronave.

Të 15 parakushtet apo prioritetet janë pasqyruar edhe në draft-kuadrin negociues të BE-së me Shqipërinë, pasi ato kanë të bëjnë me reformat sistemike, duke përfshirë Gjyqësorin, Administratën Publike dhe Reformën Zgjedhore. Drafti i kuadrit negociator njih nevojën e vendit për të hartuar dhe miratuar tre udhërrëfyes përkatës për të njëjtat tema, të cilat do t'i nënshtrohen një shqyrtimi të vazhdueshëm nga Komisioni:

- Udhërrëfyesi për reformën e Administratës Publike;
- Udhërrëfyesi për kapitujt e Sundimit të Ligjit (23 dhe 24); si dhe
- Udhërrëfyesi për funksionimin e institucioneve demokratike.

Raporti vjetor i Komisionit për vitin 2020 vlerësoi se Shqipëria plotësonte grupin e parë të kushteve, prandaj ftoi Këshillin të vazhdonte me konferencën e parë ndërqeveritare. Por mosmarrëveshjet mbi identitetin, trashëgiminë kulturore dhe gjuhësore midis Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut bllokoi përkohësisht hapjen e negociatave.⁷ Qëndrimi i përgjithshëm i Këshillit Europian ishte që Shqipëria të mos shkëputej nga Maqedonia e Veriut. Me këtë qëndrim, vendimi për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare u shty sërish.

Refuzimi i Bullgarisë për të hequr veton ndaj Maqedonisë së Veriut vonoi përpjekjen e Shqipërisë për të mbajtur konferencën e parë ndërqeveritare me BE-në gjithashtu në vitin 2021. Në tetor 2021, Komisioni publikoi raportin e tij vjetor të progresit për Shqipërinë, duke vlerësuar se ajo përmbushi shumicën e kushteve të përcaktuara nga Këshilli Europian. Pavarësisht përpjekjeve për të zhbllokuar krizën mes Bullgarisë dhe

⁷ Jacopo Barigazzi, "Bulgaria blocks EU membership talks for North Macedonia", Politico.eu, November 17, 2020.

Maqedonisë së Veriut, nuk u arrit asnjë marrëveshje. Dhjetorin e kaluar, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme miratoi njëzëri konkluzionet e Këshillit European për zgjerimin, ku u rikonfirmua angazhimi i BE-së për mbajtjen e konferencave të para ndërqeveritare me Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe me Shqipërinë sa më shpejt të jetë e mundur.⁸ Por Këshilli nuk përcaktoi një afat kohor të saktë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Sofjes dhe Shkupit. Si rezultat, nuk u caktua asnjë datë fikse për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare me Shqipërinë.

Megjithatë, Shqipëria ka punuar për të përmbushur kriteret e anëtarësimit dhe pritet të ulët në tryezën e negociatave sa më shpejt të jetë e mundur. Në vitin 2020, BE-ja prezantoi një Metodologji të Re të zgjerimit, duke adresuar kritikën e shtuara nga disa shtete anëtare dhe dinamika e re e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Rruga e anëtarësimit të Shqipërisë tani i nënshtrohet mekanizmave dhe ndryshimeve që sjell Metodologjia e Re, të cilat, siç thonë disa vëzhgues, janë "të thella dhe thelbësore". Në këtë kontekst, mbetet për t'u parë se si do të ndikojë Metodologjia e Re në bisedimet e anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në. Ky dokument politikash do të përpiqet të shpjegojë rritjen e Metodologjisë së Re, dhe të vlerësojë ndikimin e saj të mundshëm në negociatat e bllokut të parë të kapitujve⁹ mes Shqipërisë dhe BE-së.

⁸ EU Renews Commitment to Enlargement Amid Concerns over Rule of Law, *Exit.al*, 15 December 2021.

⁹ *Parimet Themelore*

METODOLOGJIA E RE E ZGJERIMIT

Metodologjia e Re ishte produkt i një konsensusi të gjerë politik midis shteteve anëtare, të cilët njohën interesat dhe shqetësimet e ndryshme që buronin nga pasiguritë për sa i përket zgjerimit të mëtejshëm të BE-së. Zgjerimi është konsideruar si një nga politikat më të suksesshme të BE-së, duke rritur në masë të madhe tregun e përbashkët, përhapur paqen, demokracinë dhe pozicionuar BE-në si një lojtar global në marrëdhëniet ndërkombëtare. Megjithatë, pas pranimit të Kroacisë, ka patur gjithnjë e më pak konsensus midis vendeve anëtare të BE-së për ritmin dhe shtrirjen e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor, duke minuar besueshmërinë e BE-së, rritur frikën e pasojave gjeopolitike dhe destabilitetit në rajon. Në këto rrethana, BE-ja kishte nevojë urgjente për të riaktivizuar politikën e saj të zgjerimit duke gjetur një ekuilibër të ri mes kapacitetit për të absorbuar anëtarë të rinj dhe ndjekjes së interesit të saj ekonomik dhe gjeopolitik në rajon, i cili po bie pre' e ndikimit rus dhe kinez.

Kjo është arsyeja pse në mars të vitit 2020, Këshilli European miratoi Propozimin e Komisionit "*Përmirësimi i procesit të anëtarësimit - Një perspektivë e besueshme e BE-së për Ballkanin Perëndimor*".¹⁰ Metodologjia e Re, siç njihet ndryshe, synon të rivitalizojë procesin e zgjerimit dhe të përforcojë angazhimin e BE-së për zgjerim në Ballkanin Perëndimor duke e bërë procesin më të besueshëm, me një koordinim politik më të fortë, më dinamik dhe më të parashikueshëm. Në prezantimin e propozimit, Komisioneri për Fqinjësinë dhe Zgjerimin, Oliver Várhelyi, tha se "zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor është përparësi kryesore për Komisionin".¹¹ Sipas tij, me forcimin

¹⁰ European Commission, Enhancing the accession process - A credible EU perspective for the Western Balkans, 57 final, 2020.

¹¹ European Commission, A more credible, dynamic, predictable and political EU accession, Press release, 5 February 2020, Brussels.

dhe përmirësimin e metodologjisë së zgjerimit, synim mbetet anëtarësimi i plotë në BE i vendeve të Ballkanit Perëndimor.¹²

Megjithëse termat e Metodologjisë së Re nuk duket shumë ndryshe në krahasim me metodologjinë e vjetër, ndryshimet dhe mekanizmat që ajo sjell janë të reja, të thella dhe thelbësore.¹³ Metodologjia e Re mbarë potencialin për t'i bërë bisedimet e anëtarësimit në BE më komplekse, procesin më politik dhe më të kontrolluar nga shtetet anëtare, të cilët bëhen aktorët më të rëndësishëm në procesin e zgjerimit. Procesi i ri bazohet në kritere objektive, në kushte më rigorozë pozitive dhe negative, dhe për herë të parë e bën zgjerimin të kthyeshëm. Angazhimi dhe koordinimi politik më i fortë, dinamizmi dhe parashikueshmëria e procesit të zgjerimit janë elementë kyç të Metodologjisë së Re. Mekanizmat e rinj vendosin një theks më të madh tek reformat themelore, duke filluar me shtetin e së drejtës, funksionimin e institucioneve demokratike dhe administratës publike.¹⁴

Besueshmëria dhe koordinimi politik

Metodologjia e Re njihë ekzistencën e hendekut ndërmjet angazhimit të vendeve kandidate ndaj reformave themelore dhe në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit nga njëra anë, si dhe hezitimin dhe paaftësinë e BE-së për të përmbushur premtimet e saj për shkak të mosmarrëveshjeve dhe pasigurive të brendshme për sa i përket zgjerimit dhe qeverisjes së BE-së. Për ta bërë procesin më të besueshëm dhe të bazuar në meritë, Metodologjia e Re forcon bashkëpunim politik midis BE-së dhe vendeve negociuese përmes samiteve të rregullta BE-Ballkani Perëndimor – dhe përfshin më shumë vendet anëtare të BE-së në monitorimin dhe vlerësimin e procesit të negociatave nga mbajtjen e Konferencave të rregullta Ndërqeveritare në nivel ministror, së bashku me Këshillat e Stabilizim Asociimit (MSA). Pra, Metodologjia e Re rrit fuqinë e shteteve anëtare kundrejt Komisionit Europian dhe institucioneve të tjera mbikombëtare të BE-së. Megjithatë, shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së duhet të flasin me një zë në rajon,

¹² Po aty.

¹³ Dragan Tilev, *The New Enlargement Methodology: Enhancing the accession process*, IDSCV, 2020.

¹⁴ European Council, *Press release on enlargement*, 11 May 2021, Brussels.

duke dërguar sinjale të qarta mbështetjeje dhe inkurajimi, dhe duke folur qartë dhe sinqerisht për mangësitë në procesin e integritit evropian.¹⁵

Këto organe do të diskutojnë ritmin e reformave dhe avancimin e procesit të negociatave të anëtarësimit në një nivel më të lartë politik. Kur vendet candidate plotësojnë kriteret objektive dhe kushtet e vendosura, shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së do të bien dakord për të ecur përpara në fazën tjetër të procesit. Kjo është arsyeja pse shtetet anëtare do të luajnë një rol më të fortë monitorues ndaj negociatave dhe do të kontribuojnë rregullisht pranë Komisionit me raporte vlerësuese. Kjo synon të sigurojë koordinimin e vazhdueshëm politik të reformave integruese, si dhe forcon përfshirjen e shteteve anëtare, me takime të rregullta me qëllim që të shqyrtohet në mënyrë konsistente zbatimi i angazhimeve dhe reformave të dakordësuara nga vendet candidate ose negociuese.¹⁶

Dinamizmi

Për të injektuar një dinamikë të ri në procesin e negociatave, kapitujt grupohen në gjashtë blloqe tematike: parimet themelore; tregu i brendshëm; konkurrueshmëria dhe rritja ekonomike; axhenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm; burimet natyrore, bujqësia dhe kohezioni; politika e jashtme. Ndryshe nga Metodologjia e mëparshme e zgjerimit, tani negociatat për secilin grup kapitujsh do të hapen në tërësi – pas përmbushjes së standardeve të hapjes, në vend të hapjes së një kapitulli individual. Negociatat mbi parimet themelore do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit. Progresi në bllokun e parë të kapitujve do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave. Blloku i parë përfshin kapitujt 23 dhe 24 (shteti i së drejtës dhe gjyqësori), kapitujt 5 (prokurimet publike), 18 (statistikat) dhe 32 (kontrolli financiar), si dhe një qasje e re në procesin e negociatave të anëtarësimit, duke sjellë brenda këtij grupi si risi, kriteret ekonomike, funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma në administratën publike.

¹⁵ European Commission, Enhancing the accession process.

¹⁶ Zoran Nechev et al, The European Union New Methodology and its long-term impact on accession negotiations, Working Paper, 2021.

Për t'i dhënë një shtysë të re procesit të negociatave, Metodologjia e Re përcakton një afat kohor më të qartë për hapjen dhe mbylljen e blloqeve të kapitujve dhe kapitujve në mënyrë individuale. Afati kohor ndërmjet hapjes së një blloku dhe mbylljes së kapitujve të veçantë duhet të jetë i kufizuar, mundësisht brenda një viti në varësi të progresit të reformave.¹⁷ Sipas Metodologjisë së Re, blloqet e kapitujve do të harmonizohen me nënkomisionet e MSA-së, në mënyrë që progresi në çdo bllok kapitujsh të monitorohet dhe të merren masa specifike të përsheptimit të përafrimit në kuadër të strukturave të MSA-së. Kjo do të mundësojë një dialog të përmirësuar dhe identifikimin e mundësive për harmonizim dhe integrim të përsheptuar në të gjitha fushat e politikave të BE-së.

Parashikueshmëria e procesit (kushtëzimi negativ dhe pozitiv)

Kushtëzimi ka qenë një nga parimet themelore të zgjerimit të BE-së që nga fillimi. Kjo politikë është forcuar vazhdimisht, veçanërisht pas zgjerimit të Madh në Europën Qendrore dhe Lindore, dhe u bë pika qendrore në politikën e zgjerimit me Ballkanin Perëndimor. E kritikuar gjerësisht si një politikë e njëanshme, por e lavdëruar për fuqinë e saj transformuese, Metodologjia e Re sjell ndryshime të rëndësishme në politikën e kushtëzimit, duke u bërë procesi i anëtarësimit më politik dhe duke rritur më tej fuqinë e shteteve anëtare të BE-së kundrejt institucioneve mbikombëtare.

Ideja prapa këtyre ndryshimeve është që procesi të bëhet më i parashikueshëm, të sigurohet qartësi më e madhe se çfarë pret BE-ja nga vendet candidate në faza të ndryshme të procesit, dhe cilat janë pasojat pozitive dhe negative të progresit ose mungesës së tij.¹⁸ BE vazhdimisht pretendon se procesi i anëtarësimit është i bazuar në meritë. Për këtë qëllim, Metodologjia e Re synon të sigurojë që kushtet për integrim të jenë objektive, të sakta, të detajuara, strikte, të verifikueshme dhe të qarta si për vendet candidate ashtu edhe për vendet anëtare që nga fillimi. Pra, të dyja palët të dinë më mirë se çfarë të presin nga njëra-tjetra dhe si të masin progresin. Kjo do të lehtësonte procesin e vendimmarrjes në organet kolegjiale të BE-së, çka ka qenë edhe thembra e Akilit për në procesin e zgjerimit. Nga njëra anë, me rritjen e qartësisë mbi kushtet e integritimit, BE rrit stimujt dhe shpërblimet për vendet candidate që zbatojnë reformat e

¹⁷ New EU Enlargement Methodology, Europe Diplomatic, 15 February 2020.

¹⁸ European Commission, Enhancing the accession process.

kërkuara dhe përmbushin kriteret e anëtarësimit. Kjo normalisht duhet të çojë në një integrim më të ngushtë dhe rritje të financimit dhe investimeve të BE-së për vendet negociuese. Nga ana tjetër, nëse ndodhin ngecje serioze ose kthim prapa, Metodologjia e Re parashikon sanksione, duke pezulluar negociatat apo edhe duke e ngrirë të gjithë procesin. Për herë të parë, procesi i anëtarësimit bëhet i kthyeshëm. Ky është edhe mekanizmi më novator që Metodologjia e Re sjell në procesin e zgjerimit të BE-së.

Ndërsa masat korigjuese, të njohura si kushtëzimi negativ, mund ta rikthejnë procesin e anëtarësimit në rrugën e sundimit të ligjit – ndryshimet në vendimmarrjen e organeve të BE-së janë shqetësuese për ritmin e procesit të negociatave. Për shembull, në rastet e kaluara, një propozim për masa korigjuese mund të paraqitet nga Komisioni ose një e treta e shteteve anëtare dhe të miratohej nga Këshilli me shumicë të cilësuar të votimit. Ndërsa sipas Metodologjisë së Re, një propozim për pezullim apo ngrirje të bisedimeve mund të bëhet nga Komisioni ose vetëm një shtet anëtar. Kjo paraqet rrezikun e ngadalësimit të procesit pasi i bën negociatat më vunerabël ndaj mosmarrëveshjeve dypalëshe midis një shteti anëtar të BE-së dhe një vendi negociues. Mbetet për t'u parë sesi do t'i shpëtojë këtij kurthi procedural zgjerimi në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi, dhe në Shqipëri në veçanti.

METODOLOGJIA E RE: THIKË ME DY PRESA NDAJ NEGOCIATAVE

Siç është argumentuar më sipër, ndryshimet në metodologjinë e zgjerimit janë thelbësore dhe ndryshime novatore. Sipas Komisionit qëllimi i tyre është të rritet besimi i palëve tek procesi dhe të korren rezultate më të mira në terren: duke rigjallëruar procesin e integritit europian, duke e bërë atë më të parashikueshëm, më të besueshëm dhe dinamik, subjekt të një koordinimi më të fortë politik, bazuar në kritere objektive dhe kushtëzim rigoroz pozitiv dhe negativ, dhe të kthyeshëm.¹⁹ Megjithatë, ka paqartësi se si Metodologjia e Re do të ndikojë në ritmin e bisedimeve të anëtarësimit të Shqipërisë me BE-në. Në veçanti, meqenëse objektivi i Metodologjisë së Re është të adresojë të metat e vendeve negociuese në fushën e shteti të së drejtës dhe funksionimit të institucioneve demokratike, mbetet për t'u parë se si do të ndikojë tek negociatat e grupit të parë të kapitujve të Shqipërisë me BE-në. Duke marrë në konsideratë elementët e rinj, Metodologjia e Re duket si një thikë me dy presa: mund të nxisë përshpejtimi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE, ngecjen ose ngrirjen e procesit.

Raundi i fundit i zgjerimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor shfaqti të meta serioze nga të dyja palët për sa i përket besueshmërisë tek procesi. Kështu, Metodologjia e Re e Zgjerimit me të drejtë adreson besueshmërinë dhe angazhimin politik nga të dyja palët e përfshira në proces, me fokus të veçantë në reformat themelore të cilat konsiderohen thelbësore për suksesin në rrugën e integritit europian. Teorikisht, duke qenë se anëtarësimi në BE është një proces i dyanshëm, një angazhim politik më i fortë nga të dyja palët do t'i çonte përpara negociatat. BE-ja pritet të përmbushë premtimet e saj nëse Shqipëria përparon me reformat e kërkuara. Metodologjia e Re do t'u japë shteteve

¹⁹ Andrej Zorko and Ionut Sibian, “Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans”, European Economic and Social Committee, 2020.

anëtare një rol më të fortë politik dhe monitorues gjatë gjithë procesit të zgjerimit. Kjo do të sjellë në një shqyrtim më të imët dhe një presion shumë më pozitiv mbi angazhimin e Shqipërisë për të përmbushur premtimet e saj dhe kriteret e anëtarësimit. Gjithashtu do të rrisë besimin e shteteve anëtare për një proces më të drejtë dhe meritore në përputhje me standardet dhe vlerat europiane, gjë që do të zhbllokonte procesin e vendimmarrjes në nivel të institucional.

Megjithëse kjo do të injektonte reformat e nevojshme në fushën e sundimit të ligjit dhe forcimin e institucioneve demokratike, peizazhi thellësisht i polarizuar politik në Shqipëri është një kërcënim i përhershëm për të gjithë procesin. Funkcionimi demokratik i institucioneve, si Kuvendi, garantimi i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme dhe garantimi i shtetit të së drejtës janë ndër prioritetet kryesore për Shqipërinë. Prandaj, zbatimi i këtyre reformave themelore dhe përmbushja e premtimeve në kuadër të bisedimeve të anëtarësimit do të kërkonte një dialog politik konstruktiv ndërmjet qeverisë dhe opozitës në të gjitha nivelet, si dhe një shoqëri civile të fortë dhe pro-aktive.

Pavarësisht se bojkoti parlamentar i opozitës ka përfunduar, mjedisi politik në Shqipëri mbetet tejet i polarizuar. Zgjedhjet e fundit parlamentare të 25 prillit u kontestuan dhe pati raportime për parregullsi zgjedhore, disa prej të cilave madje u vunë raportuan nga misioni monitorues i OSBE/ODHIR.²⁰ Proceset zgjedhore në përgjithësi janë karakterizuar kryesisht nga parregullsi dhe qeverisja nga qasja fituese i merr të gjitha.²¹ Për më tepër, Partia Demokratike, partia kryesore opozitare, po kalon një krizë të thellë të brendshme pasi humbi zgjedhjet e fundit parlamentare dhe ish-udhëheqësi i saj u shpall *persona non grata* nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Kjo e ka acaruar atmosferën politike dhe ka kontaminuar dialogun ndërpartiak në Shqipëri, i cili konsiderohet i domosdoshëm për zbatimin e reformave strukturore dhe për përmbushjen e kriterëve politike për institucionalizimin e një demokracie funksionale në vend. Gjatë gjithë këtyre viteve Shqipëria ka shënuar rezultate shumë të dobëta për sa i përket qeverisjes demokratike dhe shtetit të së drejtës.²² Në mungesë të standardeve të vërteta demokratike dhe të konsensusit bipartizan për reformat themelore, një shoqëri civile e fuqizuar mund të kapërcejë hendekun e krijuar. Por në Shqipëri shoqëria civile

²⁰ OSCE/ODIHR, “ODIHR Limited Election Observation Mission”, 2021, final report, Tirana.

²¹ BTI, Albania Country Report.

²² Arolda, Elbansani. The “Stability” of Albanian Democracy without Rule of Law: Political Polarization, Captured Institutions and Periodical Crisis.

mbetet e dobët dhe deri diku e politizuar. Metodologjia e rishikuar heziton të njohë plotësisht meritat e rolit të saj në bisedimet e pranimit në BE dhe të sigurojë më shumë fonde.²³

Shqipëria ka bërë progres në reformën në drejtësi, ka krijuar dhe bërë plotësisht funksionale institucionet e sapokrijuara gjyqësore. Progres-raporti i fundit i Komisionit për Shqipërinë thotë se vendi ka avancuar në reformën në drejtësi dhe është mesatarisht i përgatitur.²⁴ Më shumë se gjysma e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë verifikuar dhe ata që nuk mund të justifikonin të ardhurat e tyre ose u pastruan nga sistemi ose u larguan me dorëheqje.²⁵ Janë krijuar dhe janë bërë funksionale institucionet e reja për vetëqeverisjen e gjyqësorit.²⁶ Kështu, Shqipëria ka çekuar disa kuti të rëndësishme deri më tani sa i përket procesit të negociatave. Kjo mund ta përshpejtojë hapjen e kapitujve dhe blloqeve të reja dhe në fund, nëse arrihet përparim, do të çojë në një integrim më të ngushtë me BE-në dhe në rritjen e investimeve dhe financimeve evropiane në vend. Megjithatë, ndërsa mandati kushtetues i organeve të vetingut po përfundon, lypet zgjatja e mandatit të tyre me votë të cilësuar në Parlament. Verifikimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ecur në mënyrë të qëndrueshme, por ka ngritur një mori vendesh vakante në sistemin gjyqësor. Sipas disa vlerësimeve të organizatave të shoqërisë civile, vonesat në verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka grumbulluar rreth njëqind mijë dosje, që presin për t'u përpunuar nga sistemi gjyqësor.²⁷ Kjo mund sjellë shkelje të rënda të të drejtave themelore të qytetarëve si dhe do të bëhet pengesë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar – çka ka shumë gjasa të sjellë vonesa në rrugën e integritit të Shqipërisë në BE.

Ndërsa, organizimi i kapitujve negociues në gjashtë blloqe tematike dhe vendosja e standardeve dhe afateve të qarta, hapëse, të ndërmjetme dhe mbyllëse mund të ndikojë pozitivisht në negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë me BE. Grupimi i kapitujve sipas ngjashmërisë tematike e bën procesin më gjithëpërfshirës, korrigjues dhe nxitës për vendet negociuese. Sipas kuadrit paraprak të negociatave të BE-së me Shqipërinë, progresi në bllokun e parë (parimet themelore) do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm

²³ Gjergji Vurmo, “A credible new accession methodology or just a face-saving exercise?”, CEPS, February 12, 2020.

²⁴ European Commission country report, Albania, 2021. Brussels.

²⁵ Statistikat e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tirane.

²⁶ Alesia Balliu, The reform of Justice in Albania, Scientific Research, Vol.11 No.03, 2020.

²⁷ Kantieri i hapur i reformes ne drejtesi, Monitor, 6 August 2021.

të negociatave dhe do të merret parasysh për vendimin për hapjen ose mbylljen e grupeve ose kapitujve të rinj.²⁸ Megjithatë, ndryshe nga metodologjia e mëparshme që u jepte vendeve negociuese mundësinë për t'u fokusuar në kapituj të caktuar, shtrydhja e 35 kapitujve në 6 blloqe pritet të rrisë kompleksitetin e negociatave dhe barrën teknike mbi ekipin negociator të Shqipërisë dhe punën e qeverisë, parlamentit dhe institucioneve të tjera. Kjo ngre shqetësime në lidhje me kapacitetin e Shqipërisë për t'iu përgjigjur me sukses dhe me shpejtësi një procesi më kompleks dhe kërkues dhe zbatimit të reformave të kërkuara. Metodologjia e Re nuk ofron mekanizma të përmirësuar dhe të qartë për të adresuar çështjen e deficensës institucionale të Shqipërisë dhe vendeve negociuese në përgjithësi. Këto mangësi mund t'i kthejnë bisedimet e negociatave me BE-në në një proces pafund dhe të lodhshëm.

Nga ana tjetër, Metodologjia e Re nxjerr në pah një nga problemet më të mëdha me të cilat është përballur Shqipëria në dekada, paaftësia e saj për të instaluar një demokraci funksionale dhe për të mbështetur shtetin e së drejtës. Vendosija e një rëndësie të veçantë tek blloku i parë (parimet themelore) njeh regresin demokratik të Shqipërisë dhe problemet e shfaqura për sa i përket funksionimit të institucioneve demokratike. Në vitin 2021 raporti Freedom House konkludonte se indeksi demokratik i Shqipërisë shënoi rënie pas më shumë se një dekade qëndrueshmërie.²⁹ Një sondazh i kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim tregon një prirje negative të besimit të publikut ndaj institucioneve publike, të cilat perceptohen si të korruptuara dhe të paafta për të ofruar shërbime publike.³⁰

Një Parlament funksional, transparent dhe bashkëpunues është thelbësor për përparimin e prekshëm të Shqipërisë në negociatat e anëtarësimit me BE. Kuvendi miraton ligje të cilat duhet të përafrohen me korpusin ligjor të BE-së, kryen mbikëqyrjen e punës së qeverisë dhe zgjedh kryesuesit e agjencive të rëndësishme, kryesuesit dhe anëtarët e bordeve të institucioneve të pavarura kushtetuese. Në vitin 2015 Kuvendi miratoi një ligj gjithëpërfshirës i cili forcoi rolin e legjislativit në integrimin Evropian të Shqipërisë. Në bazë të këtij ligji u krijua Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, u rrit ndjeshëm roli monitorues, mbikëqyrës dhe koordinues i Parlamentit, duke e vendosur

²⁸ Council of the EU, "Accession Negotiations with the Republic of Albania – General EU Position", Not final.

²⁹ Freedom House, "Country report, Albania", 2021.

³⁰ IDM. Opinion poll, Trust in Governance. Final report, IDM, 2018, Tiranë.

kësisoj Kuvendin në qendër të procesit të integrimit Evropian të vendit.³¹ Brenda këtij kuadri ligjor, Parlamenti zhvillon seanca dëgjimore vjetore për Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin në BE dhe gjetjet e raportit vjetor të progresit të Komisionit për Shqipërinë, si dhe shërben si koordinator ndërinstitucional për sa i përket integrimit Evropian të vendit. Megjithatë, Kuvendi nuk duket se e ka ushtruar fuqinë e jashtëzakonshme që i është dhënë në procesin e integrimit. Seancat dëgjimore me qeverinë dhe roli i saj koordinues me aktorët e interesuar ose mungojnë ose nuk komunikohen tek publiku i gjerë. Kjo ka normalizuar mungesën e progresit të Shqipërisë në rrugën e anëtarësimit në BE.³²

Megjithëse Parlamenti ka krijuar një platformë për konsultimin e projektligjeve, konsultimi publik me shoqërinë civile dhe grupet e interesit mbetet formal dhe i kufizuar.³³ Probleme të ngjashme raporton edhe Instituti i Studimeve Politike. Raportet e tij vjetore të monitorimit tregojnë se bashkëpunimi i Parlamentit me shoqërinë civile mbetet i dobët, por ka pasur progres për sa i përket transparencës. Sipas ISP-së, Kuvendi nuk e ka realizuar plotësisht funksionin e tij mbikëqyrës mbi ekzekutivin dhe seancat plenare janë të dominuara nga retorika nënçmuese dhe mungesa e dialogut politik.³⁴ Parlamenti ka vazhduar të miratojë ligje në përputhje me standardet e BE-së, por gjithashtu janë miratuar ligje me porosi dhe dispozita të diskutueshme nga pikëpamja kushtetuese.³⁵ Mbetet e paqartë se si Metodologjia e Re do të adresojë dhe ndihmojë në kapërcimin e dobësive strukturore të arkitekturës institucionale të Shqipërisë në një kohë kur fuqia transformuese e BE-së në Ballkanin Perëndimor është zbehur dhe lodhja nga zgjerimi ka bërë të veten në Shqipëri dhe në rajon gjithashtu.

Kthyeshmëria e procesit të integrimit, e maskuar nën termin parashikueshmëri, elementi më radikal i Metodologjisë së Re të zgjerimit ka më shumë gjasa të ngadalësojë rrugën e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, sesa ta përshpejtojë atë. Gjashtëmbëdhjetë vite që kur Shqipëria nënshkroi MSA-në, progresi në përafrimin ligjor me BE-në ka qenë i shpejtë, por zbatimi ka ecur me ritëm të ngadaltë. Masat korigjuese dhe qasja më ndërqeveritare ndaj procesit të zgjerimit të BE-së është një ofertë e tipit *“merre ose vdis”*

³¹ Ligj nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

³² Altin, Gjeta. Albania’s EU Accession Debacle Is Becoming the New Normal, Balkan Insight, 2021.

³³ European Commission, “Albania Report”, 2021, Final, Brussels.

³⁴ Deputetet, Kuvendi dhe Aktiviteti Parlamentar në Shqipëri. Raport monitorimi i Kuvendit, ISP, 2020 Tiranë.

³⁵ Deconstructing State Capture in Albania 2008 – 2020, IDM, 2020, Tirana

ndaj vendeve candidate. Stimujt me integrim më të ngushtë dhe fonde të shtuara mund të nxisin angazhimin e Shqipërisë për përparim në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit në BE. Por kjo kërkon vullnet të fortë politik dhe bashkëpunim ndërpartiak, veçanërisht në Kuvend. Në rast të shkeljes së rëndë të vlerave të BE-së, ngecjes ose kthimit prapa, sanksionet mund të shërbejnë si mjet për të thyer status-quo-në dhe për të rigalvanizuar përpjekjet e Shqipërisë për anëtarësim në BE. Por, procedura e re e vendimmarrjes në procesin e zgjerimit për masat korrigjuese mbart rrezikun e qenësishëm të përmbysjes së procesit. Ndryshe nga metodologjia e mëparshme, me Metodologjinë e Re, një shtet anëtar ose vetë Komisioni ka fuqinë të ngrijë ose pezullojë bisedimet e anëtarësimit krejtësisht për arsye të motivuara, si dhe të reduktojë financimet për vendin negociues. Meqenëse Shqipëria është vunerabël ndaj krizave të shpeshta politike dhe mungesës së kapaciteteve dhe koordinimit ndër-institucional, fuqia e vetos së një shteti të vetëm anëtar mund t'i bëjë negociatat e saj me BE-në të brishtë kundrejt kushteve negative të implementuara rishtazi.

Së fundi, politika e jashtme e Shqipërisë dhe angazhimi i saj për marrëdhënie të mira fqinjësore, është plotësisht në përputhje me Procesin e Stabilizim-Asociimit dhe politikën e jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Shqipëria nuk ka mosmarrëveshje serioze me vendet fqinje siç kanë Maqedonia e Veriut, Serbia, Kosova dhe Bosnja – megjithatë, mosmarrëveshja e kufirit detar me Greqinë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë (GJND) qëndron si shpata e Damokleut mbi bisedimet e saj me BE-në. Një zgjidhje e shpejtë dhe e drejtë, sigurisht, do të hiqte një pengesë të rëndësishme nga rruga e anëtarësimit të saj në BE, por nëse vendimi vonohet, mund të pengojë avancimin në integrimin europian të Shqipërisë. Në fakt, kjo është pranuar edhe në draftin e pozicionit negociues të BE-së, i cili kërkon një vendim të pranueshëm reciprokisht në GJND. Për më tepër, rruga e integritit të Shqipërisë është lidhur deri tani me progresin e Maqedonisë së Veriut. Kryeministri i ri i Bullgarisë, Kiril Petkov, u zotua për një kthesë në qëndrimin e Bullgarisë ndaj ambicieve europiane të Maqedonisë së Veriut. Ai propozoi një proces të ri për Maqedoninë e Veriut, shumë të shpejtë, me një afat kohor të kufizuar, vetëm gjashtë muaj për të arritur një marrëveshje.³⁶ Duke qenë se në Bruksel nuk ka vullnet për të shkëputur Shqipërinë nga Maqedonia e Veriut, kjo do të thotë se negociatat e Shqipërisë me BE-në do të shtyhen të paktën edhe për gjashtë muaj të tjerë.

³⁶ New Bulgarian PM pledges U-turn on North Macedonia's EU ambitions, Financial Times, 14 December 2021.

PËRFUNDIME

Metodologjia e Re zgjerimit të BE-së ka sjellë ndryshime thelbësore në aspektet teknike dhe politike të procesit të integrimin European. Pas një dekade ngërçi në politikën e zgjerimit, qëllimi i Metodologjisë së Re është të thyjë status quo-në dhe ta transformojë zgjerimin në një proces më të besueshëm, dinamik dhe të parashikueshëm. Ndryshimet e sjella adresojnë të metat e viteve të kaluara, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit, parimeve demokratike dhe reformave themelore në vendet candidate, si dhe zbehjen e besueshmërisë dhe angazhimit të BE-së ndaj zgjerimit të mëtejshëm.

Për ta bërë procesin më të besueshëm, Metodologjia e Re forcon bashkëpunimin politik ndërmjet BE-së dhe vendeve negociuese/kandidate. Të dyja palët do të punojnë më shumë së bashku përmes samiteve të rregullta, konferencave ndërqeveritare dhe takimeve të organeve të MSA-së për të siguruar që progresi të arrihet dhe matet nga një monitorim më i afërt nga shtetet anëtare. Nga ana tjetër, nëse arrihet përparim i prekshëm, veçanërisht në reformat themelore, BE do të flasë me një zë dhe do të shpërblejë vendet candidate ose negociuese. Kjo ka për qëllim t'i afrojë të dyja palët dhe ta bëjë procesin më meritore dhe më të besueshëm.

Ndërsa, grupimi i kapitujve në gjashtë blloqe tematike e bën procesin më dinamik dhe më kompleks në të njëjtën kohë. Në vend të kapitujve individualë, tani negociatat për secilin grup do të hapen në blloqe kapitujsh. Kjo u jep vendeve negociuese mundësinë për të avancuar më shpejt në rrugën e anëtarësimit në BE nëse përmbushen standardet e kërkuara. Megjithatë, grupimi i kapitujve në blloqe pritet të rrisë kompleksitetin e negociatave. Për vende si Shqipëria, me kapacitet dhe koordinim të ulët institucional, procesi i negociatave do të jetë sfidues, veçanërisht për të përballuar ritmin dhe ngarkesën e punës në zbatimin e reformave të kërkuara.

Së fundi, kthyeshmëria e procesit të integritimit është elementi më i ri dhe thelbësor i Metodologjisë së Re. Anëtarësimi në BE ka qenë gjithmonë një proces politiko-teknike, por Metodologjia e Re e politizon zgjerimin më shumë se kurrë duke rritur rolin e shteteve anëtare në monitorimin dhe vlerësimin nga afër të reformave të vendeve kandidate, duke raportuar pranë Komisionit dhe marrë pjesë në mënyrë më aktive në konferencat ndërqeveritare. Përveç kësaj, Metodologjia e Re sjell ndryshime të mëdha në procesin e vendimmarrjes të zgjerimit. Ajo forcon të drejtën e vetos së shteteve anëtare gjatë bisedimeve të anëtarësimit me vendet negociuese. Në të kaluarën, procesi i anëtarësimit në BE ishte i pakthyeshem. Me prezantimin e Metodologjisë së Re, një shtet i vetëm anëtar ose vetëm Komisioni mund të pezullojë ose të ngrijë negociatat me vendet negociuese nëse ka regres ose shkelje serioze të vlerave dhe standardeve të BE-së. Në rast se vendet negociuese plotësojnë kushtet, kjo do të çojë në integrimin e tyre më të ngushtë me BE-në dhe rritje të investimeve. Ndërsa ky duket si një ekuilibër i mirë midis *"shkopit dhe karotës"*, procedura e re vendimmarrëse mbetet e brishtë përkundrejt mosmarrëveshjeve të mundshme dypalëshe midis shteteve anëtare dhe vendeve negociuese.

Si përfundim, Metodologjia e Re është një dritare mundësie për të përshpejtuar anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Por, në të njëjtën kohë ajo mund të shndërrohet në një frut të idhët për ambiciet integruese të vendit. Një përqendrim më i madh tek reformat themelore, veçanërisht në sundimin e ligjit dhe funksionimin e institucioneve demokratike, potencialisht mund të ndalojë ngecjen dhe të përshpejtojë integrimin e Shqipërisë në BE. Forcimi i bashkëpunimit politik ndërmjet BE-së dhe vendeve negociuese do të çojë në një monitorim dhe vlerësim më të imët të reformave në vendet negociuese nga shtetet anëtare dhe institucionet e BE-së. Kjo do të prodhojë një presion më pozitiv ndaj angazhimit të Shqipërisë karshi kriterëve të anëtarësimit. Megjithatë, progresi në bllokun e parë (parimet themelore) do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave, përparimi i mirë i Shqipërisë në reformën në drejtësi do ta afrojë vendin më pranë BE-së. Kjo pritet të stimulojë përpjekjet e saj në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të mbrojë të drejtat e qytetarëve dhe përfundimisht ta çojë Shqipërinë drejt integritimit më të afërt dhe rritjes së asistencës financiare dhe teknike nga BE. Megjithatë, reforma në drejtësi nuk ka përfunduar ende dhe ka pasur kritika në rritje ndaj ritmit dhe paanshmërisë së verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Afati kushtetues i organeve të vetingut duhet të zgjatet me votim të

cilësuar në Kuvend. Por, mjedisi politik i polarizuar dhe mungesa e dialogut politik të nivelit të lartë midis qeverisë dhe opozitës mund të vonojë votimin dhe të hedhë në erë punën e mbetur në gjyqësor.

Përveç kësaj, grupimi i kapitujve në gjashtë blloqe tematike do t'i bëjë negociatat më dinamike, gjithëpërfshirëse dhe kërkuese. Shqipëria ka tashmë nivel të pranueshëm përgatitjeje në fushën e sundimit të ligjit dhe funksionimit të institucioneve demokratike. Legjislacioni i miratuar në Parlament është kryesisht në përputhje me korpusin e ligjeve të BE-së – por ka pasur një hendek në rritje midis ligjeve në letër dhe zbatimit të tyre – si dhe roli mbikëqyrës dhe koordinues i Kuvendi në procesin e integritimit nuk ka përmbushur pritshmëritë. Një monitorim dhe raportim më i afërt nga shtetet anëtare mund ta ndihmojë Shqipërinë të kapërcejë këtë hendek, të vendosë në lëvizje axhendën e saj reformuese dhe të ecë më shpejt përpara.

Megjithatë, Metodologjia e Re i ka shndërruar negociatat e anëtarësimit në një proces më kërkues dhe kompleks. Negociatat kërkojnë shumë më tepër ekspertizë dhe vullnet më të fortë politik në të gjithë spektrin politik në vendet negociuese. Shqipëria ka shfaqur dobësi të vazhdueshme institucionale dhe mungesë koordinimi për sa i përket përmbushjes së kushteve të anëtarësimit në BE. Ajo është gjithashtu vunerabël ndaj krizave artificiale politike, të cilat mund të zvarritin integrimin e vendit në BE. Së fundi, ndryshe nga metodologjia e mëparshme e zgjerimit, procesi i anëtarësimit tani është bërë i kthyeshëm. Fuqia e vetos së shteteve anëtare është rritur kundrejt institucioneve mbikombëtare të BE-së në mënyrë që t'u jepet atyre një zë më i fortë në politikën e zgjerimit mes të rritjes së euroskepticizmit dhe populizmit në disa kënde të Europës. Megjithëse Shqipëria kultivon marrëdhënie të mira fqinjësore dhe nuk ka mosmarrëveshje serioze me asnjë shtet anëtar të BE-së, mekanizmi i kushtëzimit negativ, siç tregoi rasti i vetos bullgare ndaj Maqedonisë së Veriut, mund të keqpërdoret për të vonuar anëtarësim e saj në BE.

REKOMANDIME

Së pari, për suksesin e Shqipërisë në procesin e integritit European është shumë e rëndësishme të vazhdojë zbatimin e reformës në drejtësi. Disa nga mangësitë e shfaqura, si ritmi i ngadaltë i procesit të vetingut dhe dyshime mbi paanshmërinë në verifikimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duhet të adresohen siç duhet për të siguruar që të arrihet progres i prekshëm dhe të ruhet besueshmëria e reformës. Kjo kërkon një vlerësim të kujdesshëm të rezultateve të deritanishme të reformës, një konsensus të gjerë politik mbi rëndësinë e gjyqësorit për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, si dhe rritje të kapaciteteve dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor. Suksesi i mundshëm në gjyqësor do të forconte sundimin e ligjit, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivele të larta, dhe do të mbronte të drejtat themelore të qytetarëve në Shqipëri. Për rrjedhojë, kjo do të çonte në hapjen e më shumë blloqeve të kapitujve negociues dhe përfundimisht do ta afronte Shqipërinë më pranë anëtarësimin në BE.

Së dyti, grupimi i 35 kapitujve në 6 blloqe do të rritë ndjeshëm vështirësinë e negociatave. Shqipëria duhet të rritë kapacitetin e saj institucional duke punësuar ekspertët më të mirë në fushat e integritit në BE dhe të forcojë bashkëpunimin e saj me shoqërinë civile. Duhet të krijohet një koordinim më i mirë ndërmjet ekipit negociator, qeverisë, kuvendit, shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara.

Së treti, meqenëse progresi në bllokun e parë të kapitujve (reformat themelore) do të përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave, funksionimi i institucioneve demokratike, veçanërisht i Parlamentit, është i një rëndësie parësore në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimin në BE. Të gjithë aktorët politikë duhet të përmbahen nga retorika boshe dhe aktet minuese të punës në Kuvend. Parlamenti duhet t'i japë përparësi vendimmarrjes transparente dhe të informuar, të harmonizojë legjislacionin e

Shqipërisë me korpusin e ligjeve të BE-së, si dhe të ushtrijë më mirë funksionin mbikëqyrës dhe koordinues në procesin e integritimit Evropian.

Së katërti, Shqipëria duhet të vazhdojë të zhvillojë marrëdhënie të mira fqinjësore dhe të harmonizojë politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë me BE-në. Një zgjidhje e shpejtë dhe e drejtë e mosmarrëveshjes mbi kufijtë detarë në Jon me Greqinë do të ishte një hap i mirë në rrugën e integritimit Evropian. Nga ana tjetër, Shqipëria duhet të pretendojë dhe punojë për një proces anëtarësimi në BE të bazuar në meritë, pa paragjykime ndaj krizës bilaterale mes Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut.

REFERENCAT

- Andrej, Zorko and Ionut, Sibian, "Enhancing the accession process – A credible EU perspective for the Western Balkans", *European Economic and Social Committee*, (2020).
- Balliu, Alesia, "The reform of Justice in Albania", *Scientific Research*, 11 (03), 2020. I aksesueshëm në https://www.scirp.org/html/5-3301029_102766.htm#ref12
- Barigazzi, Jacopo, "Bulgaria blocks EU membership talks for North Macedonia", *Politico.eu*, November 17, 2020. I aksesueshëm në <https://www.politico.eu/article/bulgaria-blocks-eu-membership-talks-for-north-macedonia/>
- BTI. Albania Country Report, 2018. I aksesueshëm në <https://www.bti-project.org/en/reports/countryreports/detail/>
- Council of the EU, "Accession Negotiations with the Republic of Albania", General EU Position, 2020: Brussels.
- Deconstructing State Capture in Albania 2008 – 2020, IDM, 2020, Tirana. I aksesueshëm në <https://idmalbania.org/deconstructing-state-capture-in-albania/>
- Elbasani, Arolda. The "Stability" of Albanian Democracy without Rule of Law: Political Polarization, Captured Institutions and Periodical Crisis. In *Radicalization(s): "Stabilitocracy and/or Radicalism Perspectives"*. Political Analysis and Commentary, 2019, 7, 63-69.
- European Commission, "Albania Report", (2015; 2016; 2017; 2018), Final: Brussels.
- European Commission, "Albania Report", (2020), *Final*: Brussels.
- European Commission, "Albania Report", (2021), *Final*: Brussels.
- European Commission, "European Neighbourhood Policy and Enlargement Negotiations, Albania", last modified 2021, Accessed October 2, 2021. I aksesueshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/enlargement-policy/negotiations-status/albania_en
- European Commission, A more credible, dynamic, predictable and political EU accession, *Press release*, 5 February 2020. I aksesueshëm në https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/IP_20_18
- European Commission, Enhancing the accession process - A credible EU perspective for the Western Balkans, 57 final, 2020
- European Council, "Council conclusions on enlargement and stabilisation and association process - Albania and the Republic of North Macedonia". Press release, Accessed September 20, 2021. I aksesueshëm në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2020/03/25/council-conclusions-on-enlargement-and-stabilisation-and-association-process/>

- European Council, "Press release on enlargement", 11 May 2021. I aksesueshëm në <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2021/05/11/enlargement-new-enlargement-methodology-will-be-applied-to-montenegro-and-serbia/>
- Freedom House, "Country Report, Albania. September 25, 2021. I aksesueshëm në <https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2021>
- General Affairs Council, 26 June 2018. I aksesueshëm në <https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/gac/2018/06/26/>
- Gjeta, Altin. "Albania's EU Accession Debacle Is Becoming the New Normal", *Balkan Insight*, November 15, 2021. I aksesueshëm në <https://balkaninsight.com/2021/11/15/albanias-eu-accession-debacle-is-becoming-the-new-normal/>
- IDM. Opinion poll, Trust in Governance. *Final report*, IDM, 2018, Tiranë
- Instituti i Studimeve Politike, Deputetët, Kuvendi dhe Aktiviteti Parlamentar ne Shqipëri. *Final*, 2021, Tiranë. I aksesueshëm në <http://deputetim.al/wp-content/uploads/2022/01/ISP-Deputetet-Kuvendi-dhe-aktiviteti-parlamentar-I-2022.pdf>
- Kantieri i hapur i reformës në drejtësi, *Monitor*, 6 August 2021. I aksesueshëm në <https://www.monitor.al/kantieri-i-hapur-i-reformes-ne-drejttesi-2>
- Ligj nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian". I aksesueshëm në https://www.parlament.al/Files/Integrimi/ligji_15-2015-1.pdf
- New EU Enlargement Methodology, *Europe Diplomatic*, 15 February 2020. I aksesueshëm në <https://europediplomatic.com/2020/02/05/new-eu-enlargement-methodology/>
- "New Bulgarian PM pledges U-turn on North Macedonia's EU ambitions", *Financial Times*, 14 December 2021. I aksesueshëm në <https://www.ft.com/content/0c724214-0342-47ff-98a6-1a07086d29c6>
- OSCE/ODIHR, "ODIHR Limited Election Observation Mission", (2021), *Final*, Accessed October 7 2021. I aksesueshëm në <https://www.osce.org/odihr/elections/albania/493687>
- Ruttershoff, Tobias, "The Opening of Accession Negotiations: A New Hope for Albania". *Tirana Observatory*, May 8, 2020. I aksesueshëm në <https://tiranaobservatory.com/2020/05/08/the-opening-of-accession-negotiations-a-new-hope-for-albania/>
- Stanicek, Branislav, "A new approach to EU enlargement". Briefing to European Parliament, March 2020.
- Statistikat e Komisionit te Pavarur te Kualifikimit. I aksesueshëm në <https://kpk.al/statistika/>
- Tilev, Dragan, "The New Enlargement Methodology: Enhancing the accession process", *IDSCV*, 2020. I aksesueshëm në <https://idscs.org.mk/en/portfolio/the-new-eu-enlargement-methodology-enhancing-the-accession-process/>
- Vurmo, Gjergji. "A credible new accession methodology or just a face-saving exercise?" CEPS, February 12, 2020. I aksesueshëm në <https://www.ceps.eu/a-credible-new-accession-methodology-or-just-a-face-saving-exercise/>